

Data 08.11.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“ Rikonstruksioni i qendrës kulturore të fëmijeve, Durres”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 45210000-2 Punime ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 106,262,235 (njëqind e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 120 ditë

Nga projektuesi është hartuar grafiku i punimeve për 240 ditë,por ky objekt për institucionin e Bashkise Durrës konsiderohet i rëndësishem për vete funksionin që ajo ka. Për këtë arsye është menduar të që të ulet afati i zbatimit i këtij projekti duke rritur fuqinë puntore.

Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhërit të grupit te Specifikimeve nr. 260 datë 25.05.2022 dhe nr.527 datë 25.10.2022. të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit per objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit te bashkise te vitit 2022-2023 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.

2. Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga: Grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktures, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 162 , datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 dhe VKM, Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Afati i realizimit të punimeve është 120 ditë.

Garancia për mbulimin e difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100'000'000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshtetet ne ne nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e

gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar , si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50’000’000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200’000’000 lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: ,Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 39, pika 5 ”Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime gjermimi në tokë.
- NP-2 B Ndertime Civile dhe industriale
- NP-7 A Ujësjetllës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- NP-11 B Ndertime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-18 A Punime topogjeodezike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	NIVELI I KLASIFIKIMIT I KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVE	
N.S – 1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve.	Prishje soleta b/a Prishje kollona, trare b/a Prishje shkalle betonarme Prishje mur tulle me pastrim Prishje e mbuleses me kapriates metalike siper salles se shfaqeve Prishje e mbuleses me kapriate metalike ne tarrace Prishje struktura kangjella metalike Prishje shtresa pllakash Prishje shtresa ne tarrace Prishje shtresa betoni Prishje strehe betoni ne hyrje Prishje suvaje ekzistuese interier Prishje vetratash ekzistuese duralumini Prishje vetrata ekzistuse druri Prishje shtrese parketi ekzistues Cmontim I dyerve ekzistuese Prishje e strukture mbuluese se salles Cmontim I platformes se skenes Cmontim I parapeteve ekzistuese Cmontim I ndricuesve ekzistues Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	A, 0-20 milionë lekë	1,915,134

NP-1 A	Punime gërmimi në tokë.	<p>Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III</p> <p>Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km</p>	A, 0-20 milionë lekë	195,722
NP-2 B	Ndertime Civile dhe industriale	<p>PUNIME BETONI DHE BETONARME</p> <p>Trare e arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m</p> <p>Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m</p> <p>Beton C20/25 plinta</p> <p>Shtrese betoni C 16/20</p> <p>F V hekur betoni periodik $\varnothing > 10$ mm</p> <p>PUNIME STRUKTURA METALIKE</p> <p>Strukture metalike S235JR & S275JR (e galvanizuar) Mbulesat</p> <p>Strukture metalike S320 (arkarecet) (e galvanizuar)</p> <p>Bulloneri ankorimi M24, L=400 mm, Gr. 4.8</p> <p>Bulloneri ankorimi M20, L=250 mm, Gr. 4.8 (UPA)</p> <p>Strukture metalike S235JR & S275JR (e galvanizuar) Shkalla 1</p> <p>Bulloneri ankorimi M20, L=330 mm, Gr. 4.8</p> <p>Bulloneri ankorimi M16, L=200 mm, Gr. 4.8 (UPA)</p> <p>Strukture metalike S235JR & S275JR (e galvanizuar) Shkalla 2</p> <p>Bulloneri ankorimi M16, L=200 mm, Gr. 4.8 (UPA)</p> <p>Bulloneri ankorimi M20, L=200 mm, Gr. 4.8 (UPA)</p> <p>Bulloneri ankorimi M20, L=330 mm, Gr. 4.8</p> <p>Strukture metalike e strehes ne hyrje (e galvanizuar)</p> <p>PUNIME HIDROIZOLIMI</p> <p>Praimer per beton MasterTile P300 - me baze akrilik copolymer (ose ekuivalent me te)</p> <p>Hidroizolim i dyshemese se tualeteve me MasterTile WP 667 - hid. 2 komponent (ose ekuivalent me te)</p> <p>Hidroizolim i mureve te gipsit te tualeteve me MasterTile WP 668 - hid. 1 komponent (ose ekuivalent me te)</p>	B, 21-50 milionë lekë	50,361,030

		Hidroizolim i mureve te tulles te tualeteve me MasterTile WP 667 - hid. 2 komponent (ose ekuivalent me te)		
		Hidroizolim me MasterSeal 582 A+B 25 +2kg (ne ambientet nen toke) ose ekuivalent me to (muret e katit - 1 deri ne 1 m lartesi) (ose ekuivalent me te)		
		Hidroizolim i dyshemese se katit -1 me MasterTile WP 667 - hid. 2 komponent (ose ekuivalent me te)		
		PUNIME CATIE DHE TARRACE		
		Vendosja e rrjetes perforcuese perpara se te vendoset shtresa hidroizoluese.		
		Hidroizolimi i gjithe sip. te taraces me hidr. MasterTile WP 666 (dy duar) (ose ekuivalent me te)		
		Hidroizolimi i jashtem i mureve anesore te taraces, me materialin MasterSeal 525 (dy duar) (ose ekuivalent me te)		
		Vendosja e shtrese termoizoluese me trashesi 5cm - Styrodur tip 3000 CS. (ose ekuivalent me te)		
		Vendosja e shtreses mbrojtese geotextile Typar SF 32/33. (ose ekuivalent me te)		
		Shtrese niveluese llac cemento me aditiv special MasterCast 301 (ose ekuivalent me te)		
		ISO-DRAIN nature 20 PG.(per gjelberimin ne tarrace) (ose ekuivalent me te)		
		MasterEmaco S488 (ose ekuivalent me te)		
		Shtrese gome Conipave PV per ambient te jashtem (shtrim i tarraces se shfytezueshme) (ose ekuivalent me te)		
		Panel sandwich me shtresa hidroizoluese dhe termoizoluese (shtrese evaporuese Tyvek SOLID, shtrese lesh guri 10 cm, shtrese hidroizoluese, shtrese mbuluese PVC)(MBULIMI I SALLES + TARRACES)		
		Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar me tjegulla vendi (vazhdimi I catise se bankes)		
		Veshje kornize llamarine xingata (gjeresi 50cm) parapetet e tarracave		
		Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33 cm		
		Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm		
		Kasete shkarkimi me llamarine xingat		
		PUNIME SHTRESASH		

		Shtrese betoni C 12/15		
		Rrjete metalike Ø8		
		Shtrese stirobetoni 20 cm		
		Shtrese niveluese llac cemento me tharje te shpejte (screed) PCI Novoment Z3 ose ekuivalent me te		
		Dysheme gome NORAPLAN 3mm se bashku me hundore gome PRAIMER+AUTONIVELANT + NGJITES+NORAPLAN + INSTALIMIN. tek shkallaret e salles se shfaqeve (ose ekuivalent me te)		
		dyscheme gome ne ambjentet e brendshme <u>noraplan me trashesi 3mm</u> . PRAIMER+AUTONIVELANT + NGJITES+NORAPLAN + INSTALIMIN. (skena e shfaqeve) (ose ekuivalent me te)		
		dyscheme gome ne ambjentet e brendshme <u>noraplan me trashesi 3mm</u> . PRAIMER+AUTONIVELANT + NGJITES+NORAPLAN + INSTALIMIN. (ose ekuivalent me te)		
		PLINTUS per dyshemete e gomes noraplan (Plintus PVC VYNAFLEX - 5cm +ngjitesi + instalimi) (ose ekuivalent me te)		
		Dysheme ne sallat e baletit		
		Shtrese me sistemin EP - MasterTop 530 per ambjentet teknike (sistem dyshemeje me fibra celiku me trashesi 2-3mm) (ose ekuivalent me te)		
		Veshje me pllake majolike		
		Shtrese me pllaka grez porcelanato (dyschemeja e tualeteve)		
		Bazamake shkalle t=3cm dru		
		Shtrime te jashtme me sistemin Conipave PV (ose ekuivalent me te)		
		Nenshtrese zhavori		
		PUNIME SUVATIMI DHE TAVANI		
		Suvatim I mureve te brendshme me Adetivin MasterCast 125.		
		Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah		
		Patinim i mureve te gipsit		

		Patinim tavani gipsi		
		Tavan I varur D112 me konstruksion metalik ne ambjentet sanitare		
		Tavan gipsi absorbues D127 Cleaneo Acoustic ,ne sallën e shfaqjeve		
		Tavan gipsi reflektues D112 ne sallën e shfaqjeve		
		Tavan gipsi absorbues D127 , Cleaneo Acoustic, (ambjentet e tjera te qendres)		
		Tavan I varur D112 me konstruksion metalik ne ambjentet e tjera te qendres		
		PUNIME VESHJE		
		Veshje metalike etalbond i perforuar ne fasade		
		Kapotim I jashtem I godines me panel termoizolues me Fasaden Termike - Caparol Basic Line - ETIC Insulating Board" - WDVS B (ose ekuivalent me te) Me EPS tip Dalmatiner $\lambda = 0.033 \text{ W/mK}$		
		Suva e jashtme me Praimer CAPATECT Putzgrund + Suva te jashteme Synthetic-Resin-Dispersion Render/ Plaster CAPATECT KD (K/R Putz - 1.5mm (ose ekuivalent me te)		
		Veshje fasade me alukobond e strehes ne hyrje		

		<p>F.V Sistemi 4 akustik asorbues dhe reflektues me vlere ne total te ambientit α_w 0.40(LM), NRC 0.70, SAA 0,70 kerkohet per te garantuar nje performance te avancuar te kombinuar me nje aspekt te larte esteti, sp.16 mm MDF E1 densiteti kg/m³ 760 / 16 mm MDF FR (klasa I qëndrueshëm ndaj zjarrit) Ngjyra Veneer, format 28/4 Gjatësia : 4061 mm, Gjeresia : 128 mm, tolerancat: width = 0,1 mm / Length = + / - 2 mm, anët e gjatë: bashkimi me ndërprerës mashkull - femër, anët e shkurtër: prerë kokën kënddrejtë (90 °) Klasifikimi i reaksionit ndaj zjarrit sipas normes EN 13501-1 klasi “B-s1,d0” Clirimi i formaldeides,klasi E1 e F**** sipas normes EN-717-1:2004 DHE JIS A1460:2001 I aplikueshem ne ndertim sipas normes EN 13986:2004</p>		
		<p>F.V Struktura, sistem me varje diametër 4mm metal dhe stafa për fiksimin ne tavan te profilin Ω. Profil metalike seksion Ω 3000x18x26 mm 16 mm MDF E1 densiteti kg/m³ 760 / 16 mm MDF FR (klasa I qëndrueshëm ndaj zjarrit) Ngjyra Veneer Gjatësia : 4061 mm ,Gjeresia : 128 mm Tolerancat: width = 0,1 mm / Length = + / - 2 mm Anët e gjatë: bashkimi me ndërprerës mashkull - femër. Anët e shkurtër: prerë kokën kënddrejtë (90 °)</p>		
		<p>F.V Profilet rifiniture ne aluminit presethyer kanë forma dhe dimensionet te ndryeshme ne forme dhe ngjyre, në mënyrë që të lidhen me kërkesat e projektit. Me koficent 45% e siperfaqes.</p>		
		<p>F.V Profilet rifiniture ne aluminit presethyer kanë forma dhe dimensionet te ndryeshme ne forme dhe ngjyre, në mënyrë që të lidhen me kërkesat e projektit. Me koficent 45% e siperfaqes.</p>		
		<p>PUNIME DYER -DRITARE</p>		
		<p>Ndarjet dhe dyert e tualeteve me HPL</p>		
		<p>F V dritare d/alumini plastike me dopio xham (4 mm transparent + 16 mm 90% ARGON + 4 mm LOW-E)</p>		
		<p>Mbulimi me skylight</p>		

		<p>Dyer P1(90x210)</p> <p>Dyer P2(85x210)</p> <p>Dyer P3(180x210)</p> <p>Dyer P4 (100x210) Proget fire antipanik</p> <p>Dyer P6(150x210)</p> <p>Vetrata druri dhe xham</p> <p>Bazamake mermeri tek dritaret dhe vetratat (t=2 cm)</p> <p>Doreza antipanik</p> <p>Mekanizem vetembybllës me shine për daljet e emergjencës, me mbajtje hapur në 90°, për dyert proget</p>		
NS-4 A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese .	<p>PUNIME BOJATISJE</p> <p>Boje Synthetic resin dispersion CapaTrend ,për tavanet e godines + astarin (ose ekuivalent me te)</p> <p>Boje Synthetic resin dispersion CapaTrend ,për ambientet e brendshme të godines+ astarin (ose ekuivalente me te)</p> <p>Boje Siloxane-reinforced, matt façade paint with silicate characteristics-Amphisil ,për ambientet e jashtme të godines (ose ekuivalente me te)</p> <p></p> <p></p> <p>PUNIME TE NDRYSHME</p> <p>Boje metali e çilesisë së lartë me rezistencë të lartë ndaj korrozionit dhe goditjeve mekanike. PercoTop 611 2K DTM Topcoat. (për lyerjen e konstruksioneve metalike) (ose ekuivalent me te)</p> <p>Pastrim dhe restaurim i fasadës</p> <p>Dhe humosor për gjelberimin në terrace</p> <p>F.V. Fidane Lule dekorative</p> <p>Ashensor platforme për PAK</p> <p>Pasqyra në sallat e baletit</p> <p>Korimano druri për ushtrimet në sallën e baletit</p> <p>Korniza dekorative dyerësh</p> <p>Perde ajri në hyrje të qendrës kulturore</p> <p>Poltrona ulje për sallën të shfaqjeve</p> <p>Poltrona ulje për sallën e vogël të shfaqjeve</p> <p>Perdet e skenës</p>	A, 0-20 milionë lekë	8,363,230

		Fusha pingpongu		
		Parapet xhami i temperuar h=90 per shkallet dhe tarracen		
NP-7 A	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.	<p style="text-align: center;">SISTEMI I MBROJTJES KUNDER ZJARRIT</p> <p style="text-align: center;">Materiali Instalimi</p> <p>F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2½" x 3.25 mm, me mberthime Victaulic</p> <p>F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2" x 3.25 mm, me mberthime Victaulic</p> <p>F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 1½" x 2.90 mm, me mberthime Victaulic</p> <p>F.V Valvol nderperese me sferë DN 40 (1½")</p> <p>F.V Rakorderi çeliku i zi (Bryla,Ti, reduksione etj). Mberthimi i rakorderive do te behet me kapje Victaulic</p> <p>F.V Mberthime te rakorderive me kapje Victaulic</p> <p style="text-align: center;">Sinjalistika & kodi indeksimit</p> <p>F.V Hidrant zjarri i jashtem</p> <p>F.V Hidrant zjarri</p> <p>F.V Fikëse zjarri me karrel</p> <p>F.V Fikëse zjarri me pluhur</p> <p>F.V Fikëse zjarri me CO₂</p> <p>F.V Buton sinjalizimi i zjarrit</p> <p>F.V Lidhja me motopompen</p> <p>F.V Zbritje shkalle</p> <p>F.V Rrezik zjarri nga pajisjet elektrike nën tension</p> <p>F.V Ndalim i shuarjes së zjarrit me uje</p> <p>F.V Dalje emergjence</p> <p>F.V Drejtim i daljes së emergjences</p> <p style="text-align: center;">Shuma A</p> <p style="text-align: center;">SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJE</p> <p style="text-align: center;">Furnizimi me uje nga rrjeti</p> <p>F.V Tubo PE - HD Ø 75x6.8 mm, PN16</p> <p>F.V Rakorderi (bryla, ti, reduksion, etj)</p> <p>F.V Valvol nderperese me sferë DN 65 (2½")</p> <p>F.V Fiter uji me rrjete DN 65, Pn 6 bar</p> <p>F.V Mates uji DN 65, Pn 6 bar</p> <p>F.V Valvol moskthimi DN 65, Pn 6 bar</p> <p style="text-align: center;">Sistemi i shperndarjes se ujit sanitar</p> <p>F.V Tubo PE -Xa, DN 50 (Ø63 X 8.6) mm</p> <p>F.V Tubo PE -Xa, DN 40 (Ø50 X 6.9) mm</p> <p>F.V Tubo PE -Xa, DN 32 (Ø40 X 5.5) mm</p> <p>F.V Tubo PE -Xa, DN 25 (Ø32 X 4.4) mm</p> <p>F.V Tubo PE -Xa, DN 20 (Ø25 X 3.5) mm</p> <p>F.V Tubo PE -Xa, DN 15 (Ø20 X 2.8) mm</p> <p>F.V Tubo PE -Xa, DN 12 (Ø16 X 2.2) mm</p> <p>F.V Rakorderi PE-Xa (bryla, ti, reduksion, etj)</p>	A, 0-20 milionë lekë	18,713,831

	F.V Termoizolim armoflex per tubo PE-Xa, DN15 (Ø20 X 2.8) mm		
	F.V Termoizolim armoflex per tubo PE-Xa, DN12 (Ø16 X 2.2) mm		
	F.V Minivalvula nderprerese per pajisjet sanitare Ø 1/2"		
	Lidhjet hidraulike tek depozitat e ujit		
	F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 3"		
	F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 2½"		
	F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 2"		
	F.V Tubo çeliku zingato dhe rakorderi Ø 1½"		
	F.V Valvol nderprerese me sferë DN 65 (2½")		
	F.V Valvol moskthimi DN 65 (2½")		
	F.V Valvol nderprerese me sferë DN 40 (1½")		
	Shuma B		
	SISTEMI I SHKARKIMIT TE UJRAVE TE ZEZA		
	Shkarkimi i brendshem i ujrave te zeza		
	Shkarkimet ne planimetri te WC-ve		
	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d125		
	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d110		
	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d75		
	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d50		
	F.V Bryla RAU - PP d125 α = 45°		
	F.V Bryla RAU - PP d110 α = 45°		
	F.V Bryla RAU - PP d50 α = 45°		
	F.V Reduksion RAU - PP d125/d110		
	F.V Reduksion RAU - PP d110/d75		
	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d125		
	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d110		
	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d75		
	F.V Manikota RAU - PP (HTU) d50		
	F.V Brag 45° d125/110		
	F.V Brag 45° d110/75		
	F.V Brag 45° d75/50		
	F.V Kunete B=25cm , kapak gize dhe grille		
	F.V Pilete dyshemeje		
	Shkarkimi i jashtem i ujrave te zeza		
	F.V Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave		
	F.V Shtrese rere + transport		
	F.V Puseta betoni (80 x 80) cm, me kapak gize		
	F.V Tubo shkarkimi PE d125		
	Shuma C		
	SISTEMI I NGROHJES FTOHJES DHE I VENTILIMIT		
	Punime Instalimi		
	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 3"		
	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 2½"		
	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 2"		
	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1½"		
	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1¼"		
	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø 1"		
	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø ¾"		

	F.V Tubo çeliku i zi pategel (Mannesmann) Ø ½"		
	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 3" x 13 / 20 mm, per dy tipe termoizolimesh brenda / jashte, te veshura me flete PVC (brenda) dhe me flete alumin (jashte)		
	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 2½" x 13 / 20mm, i veshur me flete PVC		
	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 2" x 13 / 20 mm, i veshur me flete PVC		
	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1½" x 13 mm, i veshur me flete PVC		
	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1¼" x 13 mm, i veshur me flete PVC		
	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø 1" x 9 mm, i veshur me flete PVC		
	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø ¾" x 9 mm, i veshur me flete PVC		
	F.V Armafleks per tubo çeliku pategel Ø ½" x 9 mm, i veshur me flete PVC		
	F.V Tubo PVC Ø 32 per largimin e kondensatit		
	F.V Tubo PVC Ø 40 per largimin e kondensatit		
	F.V Tubo PVC Ø 50 per largimin e kondensatit		
	Ventilimi i sallave te baletit		
	F.V Kanale ajri - llamarine zingato $\delta = (1 \div 0.6)$ mm		
	F.V Grile dhenie me 2 rreshta te levizshem me damper. Materiali alumin RAL 9010. Prurja e ajrit 550 m ³ /h, 400x150 mm		
	F.V Grile thithje tip lineare me 1 rresht te inklinuar 0° me damper. Materiali alumin RAL 9010. Prurja e ajrit 550 m ³ /h, 400x150 mm		
	F.V Grile thithje tip lineare me 1 rresht te inklinuar 0° me damper. Materiali alumin RAL 9010. Prurja e ajrit 2200 m ³ /h, 1000x300 mm		
	F.V Grile shiu Prurja e ajrit 1100 m ³ /h, 400x400 mm		
	F.V Konstrukione metalike dhe armatura montimi profile metalike c=(20x20x1), Prizhonier M8/M6, bulloneri, nastro adezive, silikon, shkume ekspansive, fasheta, sfungjer rikofon, antivibrues, upa metalike betoni M8/M6, elektroda saldimi, gur fresibel, boje antiruxho gri ,etj		
	Ventilimi i tualeteve		
	F.V Kanale ajri - llamarine zingato $\delta = (1 \div 0.6)$ mm		
	F.V Valvola ajrimi per tualete. Materiali alumin RAL 9010. Prurja e ajrit 150 m ³ /h, Ø125		
	Grile tranzit 200x150		
	Kondicionimi i salles se koncerteve		
	F.V Kanale ajri drejtkendore prej llamarine te zinguar, sp.0,8mm, pjese te drejta dhe speciale		
	F.V Veshje termoizoluese, pambuk guri + alumin per izolimin e kanaleve te ajrit ne pjesen e jashtme ne fasade		
	F.V Boje speciale kundra kondensimit per kanalet e dhenies se ajrit, pjeset e dukshme (lyerje 2 here)		

		F.V Materiale te imeta per fiksimin dhe varjen e tubave dhe paisjeve		
		F.V Difuzore tip elikoidale me hedhje te ajrit me gjeometri variabe me induksion te larte i pershtatshem per lartesi instalimi mbi 8 m. I paisur me suste termostatike per rregullimin e fleteve sipas stines. Materiali alumin RAL 9010. Instalimi me plenum llamarine te zinguar te izoluar me damper Prurja e ajrit 1272 m3/h, Ø315 mm, 50Pa, 40dB		
		F.V Tub fleksibel i termoizoluar DN 315		
